

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit, bazuar në Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr.95/2016 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, Vendimin nr. 727 të Autoritetit për planin e rekrutimeve për vitin 2020, shpall kërkesën për konkurrim për punonjës me kontratë, me kohëzgjatje të pacaktuar, me kohë pune 8 orë në ditë, për vendin vakant në pozicionin:

I – Magazinier

Ky pozicion konsiston në ruajtjen dhe administrimin e çdo materiali që ndodhet në magazinë, si dhe bën evidentimin e çdo lëvizje të tij..

II - Detyrat/përgjegjësitë;

- Është përgjegjës për vendosjen, sistemimin dhe administrimin e gjithë materialeve që ndodhen në magazinë.
- Bën inventarizimin e materialeve, dokumenton çdo lëvizje në magazinë (hyrje ose dalje), si dhe transferon materiale sipas një kërkesë të aprovuar nga titullari.
- Është përgjegjës për ruajtjen e vlerave materiale sipas kushteve teknike që kërkon secili prej tyre.
- Është përgjegjës për rregullsinë dhe ligjshmërinë e plotësimit të gjithë dokumentacionit të hyrjes (marrjes në dorëzim) apo daljes (dorëzimit) të materialeve, si fletëhyrje, fletëdalje, procesverbale etj.
- Plotëson ditarin e magazinës për çdo lëvizje, hyrje-daljet, dokumentet dhe kartelat përkatëse.
- Mban procesverbale për çdo incident, thyerje, dëmtim apo shpërdorim.
- Mban inventarin e gjendjes së mallit në magazinë dhe përgatit raporte periodike.
- Bën raportime ditore tek eprori i drejtpërdrejtë.
- Çdo fillim muaji rakordon me sektorin e financës
- Kryen detyra të tjera sipas kërkesës së eprorëve.

III - Kualifikimet/Kërkesat

- Niveli arsimor: arsim i mesëm, ose i lartë i preferueshëm në fushën ekonomike.
- Eksperiencë pune jo më pak se 1 vit. Do të kenë prioritet kandidatët që kanë eksperiencë pune konkrete si magazinier.
- Aftësi shumë të mira në formulimin dhe përgatitjen e dokumentacionit zyrtar.
- Aftësi shumë të mira komunikuese dhe organizuese.
- Aftësi për të dhënë sugjerime dhe alternativa për zgjidhjen e problemeve dhe situatave.
- Të jetë i besueshëm, i përgjegjshëm dhe të përmbushë detyrimet e punës.
- Njohje të mirë të punës me kompjuter, veçanërisht të programeve standarde MS Office.
- Te zotërojë leje drejtimi automjetesh të nivelit, klasit B

IV - Dokumentacioni;

- Kërkesë, letër motivimi.
- Një kopje të jetëshkrimit në formatin europass.
- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sporti.
- Fotokopje të listës te notave, nëse ka listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë).
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID).
- Fotokopje të lejes së drejtimit të automjeteve te nivelit, klasit B
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore.
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.
- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- Emër, adresë dhe numër kontakti të punëdhënësit të fundit.

Shënim;

- Kandidatët që aplikojnë duhet të plotësojnë gjithashtu kushtet e parashikuara në pikën 3 të nenit 12 të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;

- Kandidatët që aplikojnë do ti nënshtrohet procedurave ligjore për pajisjen me Certifikatë Sigurie

V – Procedura, përzgjedhja e kandidatëve:

- Kërkesa për aplikim dhe dokumentacioni përkatës duhet të dorëzohen pranë zyrave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), në adresën; Rr. “Ibrahim Rugova”, Garda e Republikës, jo më vonë se data **16/3/2019**
- Përzgjedhja fillestare e kandidatëve do të bëhet mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur. Të gjithë kandidatët do të njoftohen me email për rezultatet e përzgjedhjes jo më vonë se data, jo më vonë se data **18/3/2020**
- Kandidatët e përzgjedhur nga faza e mësipërme do ti nënshtrohen një interviste me gojë, jo më vonë se data **20/3/2020**.
- Kandidati fitues do të njoftohet me email, për të vazhduar me kompletimin e dokumentacionit dhe nënshkrimin e kontratës jo më vonë se data **23/03/2020**.